



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 24-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 28.02.2024, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Burim Rrustemi, DSHPMM
2. Rexhep Rexhepi

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të e KPF-se.
2. Propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Lipjanit për vitin
3. Raport Financiar i KRM "PASTRIMI" SH.A për njësinë Operative të Lipjanit për vitin 2023
4. Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023
5. Raporti i përformancës së komunës së Lipjanit për vitin 2022
6. Raporti, Janar-Dhjetor 2023, i punës së zyrës së Kryetarit dhe drejtorateve komunale

Dhe një pikë shtesë do ta keni

7. Vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Lipjanit 2024-2028

Pastaj tha do ta keni edhe një pikë shtesë me propozim të ekzekutivit

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës me pikës shtesë dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi rendin e ditës:

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 23-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 23-të të KPF-së

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

Raporti e a jeni i pajtimit që të shkoj direkt në Kuvend.

Me të gjitha votat prezentë kaloi direkt për kuvend

II

Propozim vendim për miratimin e raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Lipjanit për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit, nga DBPZHR i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha a janë këta të gjithë fermer apo?

Rexhep Rexhepi, tha po fermer janë shumica?

Alban Salihu, tha është mire që na si anëtar të kuvendit me e pa listën se kush janë këta fermer? Pyetja tjetër a ka ndodh që ndonjë fermer është refuzuar nga ana juaj? A ka pas ndonjë komision që i ka vlerësuar këto dëme .

Arsim Jashari, tha se edhe unë pajtohem që duhet të kemi listën e personave që janë shkuar për mbështetje, pasi që ne jemi anëtar të kuvendit dhe e kemi dhen betimin, kur kemi filluar punën.

Rexhep Rexhepi, tha se jo komisioni nuk e ka refuzuar asnjë, ne e kemi bere listën dhe ajo listë do të shkojnë në Agjencinë për Emergjencë, por a do të ju ndihmojnë a jo unë nuk e di.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se tani i kemi raportet, a pajtoheni që raportet di dërgojmë në kuvend pikat:

3.Raport Financiar i KRM "PASTRIMI" SH.A për njësinë Operative të Lipjanit për vitin 2023

4.Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

5.Raporti i performancës së komunës së Lipjanit për vitin 2022

6.Raporti, Janar-Dhjetor 2023, i punës së zyrës së Kryetarit dhe drejtorateve komunale

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit nga DSHPMM e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se shpresoj qe me te vërtet te jene përmirësuar ato gabime dhe te behet ne mënyrën me te mirë pasi qe shume ka pas gabime herën e kaluar.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha janë munduar te gjithë akteret te punojnë dhe te përbirohen ato lëshime ku kane mbetur.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi